



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS
SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.



VENDIM

Nr. 08, datë 2.5.2024

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT "PUNËSIMI I PROFESIONISTËVE TË RINJ NË
SHOQËRINË "ALBPETROL" SH.A", PËR VITIN 2024

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, Vendimit nr. 570, të Këshillit të Ministrave, datë 03.10.2018, "Për Këshillat Mbiqëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore", nenit 21 të Statutit të shoqërisë "Albpetrol" Sh.A., Këshilli Mbiqëqyrës i shoqërisë "Albpetrol" Sh.A, në mbledhjen e datës 2.5.2024

V E N D O S I:

1. Miratimin e Programit "Punësimi i Profesionistëve të rinj në shoqërinë "Albpetrol" Sh.A", për vitin 2024 (në vijim referuar si "Programi i Punësimit").
2. Miratimin e Rregullores së Programit "Punësimi i Profesionistëve të Rinj në shoqërinë "Albpetrol" Sh.A", bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
3. Miratimin e numrit të profesionistëve të rinj, pjesëmarrës në Programin e Punësimit, prej 20 (njëzetë) aplikantësh.
4. Paga e vendit të punës e aplikantëve të përzgjedhur nga Programi i Punësimit do të jetë 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë në muaj (paga bruto), mbi të cilën të llogariten kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale.
5. Pas përfundimit të periudhës së provës, shoqëria "Albpetrol" Sh.A, në përputhje me performancën e punës së aplikantëve të përzgjedhur nga Programi i Punësimit, mund të ofrojë punësimin e tyre pa afat, në vendet e lira të punës.
6. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 1.06.2024.



7. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI MBIQYRËS

Ilia GJERMANI

KRYETAR




Ami KOZELI

ANËTAR




Ermal NUFI

ANËTAR




Evis MAMAJ

ANËTAR




Florenca KORBI

ANËTAR



Edmond AHMETI

ANËTAR



RREGULLORE

PËR PROGRAMIN “PUNËSIMI I PROFESIONISTËVE TË RINJ NË SHOQËRINË “ALBPETROL” SH.A”

Shoqëria Albpetrol SH.A., krijon mundësitë më të mira për punësimin e profesionistëve të rinj, të kanë studiuar brenda ose jashtë vendit në fusha, të cilat lidhen me nevojat dhe objektivin kryesor të kësaj shoqërie.

Programi “Punësimi i profesionistëve të rinj në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A”, më poshtë cituar si “Programi i Punësimit”, synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën e shoqërisë dhe në Qendrat në varësi të saj, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre praktike në njohje me aktivitetin e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.

KREU I

Neni 1

Nevojat për punësim

Shoqëria Albpetrol Sh.A. parashikon çdo vit nevojat për rekrutimin e specialistëve dhe punëson specialistët, të cilët kanë rezultuar më të mirët përgjatë procesit të konkurrimit të hapur.

Neni 2

Identifikimi i nevojave për punësim

1. Drejtorja e Burimeve Njerëzore, krahas procesit të plotësimit të vendeve të lira të punës, të cilat krijohen si pasojë e lëvizjeve ose transferimeve të specialistëve në vende të tjera, si dhe të atyre që përfitojnë nga e drejta për pension, identifikon kohë pas kohe nevojat e njësive të tjera të Albpetrol Sh.A. për burime njerëzore, duke u fokusuar në performancën e treguar nga stafi i çdo njësie.
2. Drejtorja e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet klasifikimit të vendeve të punës që renditen brenda sistemit të vlerësimit të performancës, paraqet çdo vit kërkesën për parashikimin buxhetor për financimin e pagesave për vendet e reja të punës që mund të krijohen si pasojë e nevojave të shoqërisë.

Neni 3

Përgatitja e procesit

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, pasi njihet me buxhetin e parashikuar për financimin e pagesës së profesionistëve të rinj që do të punësohen në Albpetrol Sh.A., përgatit dhe ndjek procesin e publikimit për këtë qëllim.

Neni 4



Identifikimi i kandidatëve që kërkojnë të punësohen pranë shoqërisë “Albpetrol” Sh.A

1. Albpetrol Sh.A. bashkëpunon me Institucionet e Arsimit të Lartë që përgatisin specialistë për fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve, për t'u njohur paraprakisht me cilësinë e kandidatëve për punësim.
2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore siguron administrimin e korrespondencës me këto institucione, duke ndjekur kohë pas kohe cilësinë dhe mbarëvajtjen e studentëve, të cilët përgatiten për t'u diplomuar.
3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, mund të vendosë kontakte më të hershme me kandidatët dhe të iniciojë komunikimin me ta, përpara kohës së diplomimit të tyre.

Neni 5

Afate

Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit shpalljen për hapjen e Programit të Punësimit, afatin për aplikim, profesionet dhe numrin e vendeve për çdo profesion, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.

Neni 6

Dokumentacioni

Pas diplomimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore vendos kontaktet zyrtare me secilin kandidat dhe përgatit një listë emërore për ta paraqitur tek Administratori.

KREU II

Neni 7

Takimi me kandidatët dhe Shprehja e Interesit

Administratori realizon takim me kandidatët e identifikuar, të cilët kanë shprehur interes të punësohen pranë Albpetrol Sh.A., (si rregull gjatë muajit Shtator), duke zhvilluar me ta një bisedë për t'i njohur ata me aktivitetin e shoqërisë, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të saj..

Neni 8

Administrimi dhe kualifikimi i dokumentacionit

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, brenda afateve të njoftuara në shpalljen për hapjen e Programit të Punësimit, administron dokumentacionin.
2. Në rastet kur dokumentacioni i dorëzuar është i pasaktë ose i pamjaftueshëm, brenda një afati kohor, por jo më vonë se tre ditë pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga aplikantit, njofton aplikantin e interesuar për plotësim.
3. Aplikanti i interesuar plotëson dhe saktëson dokumentacionin e dorëzuar brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit.
4. Në rast tejkalimi të këtij afati, Drejtoria e Burimeve Njerëzore vendos, sipas rastit, që ta

20

përfshijë, apo ta kualifikjë për më tej kandidatin.

Neni 9

Përgatitja e pasqyrës së të dhënave

Drejtoria e Burimeve Njërëzore, mbi bazën e kriterëve të parashikuara në shpalljen për hapjen e Programit të Punësimit, përgatit tabelën përmbledhëse me emrat e kandidatëve që i plotësojnë ato dhe të dhënat e tjera që kërkohen në publikimin e bërë.

Neni 10

Konkurrimi i hapur

Administratori i Albpetrol Sh.A. përcakton mënyrën e konkurimit dhe të përzgjedhjes së specialistëve duke përcaktuar në një urdhër, si vijon:

- a) Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët që do të përfshihen në Programin e Punësimit, sipas profesioneve;
- b) numrin e aplikantëve që do të përzgjidhen nga Programi i Punësimit, sipas profesioneve;
- c) komisionin e vlerësimit;
- d) datën, orën dhe vendin për zhvillimin e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë;
- e) personat përgjegjës për hartimin e testit;
- f) numrin e testeve që do të përpilohen.

Neni 11

Shpallja e fituesve

Fituesit shpallen pasi procesi i konkurimit (testimi me shkrim dhe intervista me gojë) është mbyllur, nuk ka ankimime dhe është miratuar nga Administratori.

Neni 12

Afati i punësimit

Kontrata e punës e aplikantëve të përzgjedhur nga Programi i Punësimit do të jetë me afat. Afati i kontratës shtrin efektet e saj nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës deri në mbyllje të vitit kalendarik.

KREU III

Neni 13

Krijimi i Njesisë së Trainimit

Albpetrol Sh.A. krijon në strukturën e vet Njësinë e Trajnimit, e cila ka në objekt të punës së saj identifikimin e nevojave për trajnim dhe përgatitjen e programeve "tip" të trajnimit. Për këto programe, Njësia e Trajnimit bashkëpunon me të gjitha njësitë strukturore të Albpetrol Sh.A. si

AV

dhe me subjekte të tjera të specializuara dhe të certifikuara.

Neni 14

Trajnimi i Kandidatëve fitues të Programit të Punësimit

Kandidatët fitues të Programit të Punësimit që bëhen pjesë e stafit të Albpetrol Sh.A., paraqesin një deklaratë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ku konfirmojnë detyrimin për t'iu nënshtuar programeve të trajnimit.

Neni 15

Programi i trajnimit

1. Për punonjësit me kontratë pune me afat, fitues të Programit të Punësimit, pas nënshkrimit të kontratës, ndërtohet një program i veçantë trajnimi, në përputhje me detyrat e vendit të punës. Periudha e trajnimit, në çdo rast, zgjat jo më pak 3 muaj.
2. Në programin e trajnimit përfshihet qarkullimi dhe qëndrimi disa javor i punonjësit të ri, fitues i Programit të Punësimit, në të gjitha njësitë zbatuese, të cilat i shërbejnë krijimit të eksperiencës bazë të punës.
3. Në program përcaktohet personi përgjegjës, i cili do të ndjekë trajnimin e punonjësit të ri, në bashkëpunim me një person të caktuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
4. Në përfundim të periudhës së trajnimit, punonjësi i trajnuar përpilon një raport përgjithësues me shkrim, për njohuritë që ka përfituar gjatë trajnimit.
5. Në fund të periudhës trajnuese, punonjësi i nënshtrohet edhe një testimi me shkrim, për njohuritë që ka përfituar gjatë trajnimit, duke iu akorduar më pas edhe dëshmia përkatëse.

Neni 16

Përfundimi i Trajnimit

1. Në përfundim të periudhës së trajnimit dhe të testimit, Njësia e Trajnimit, nëpërmjet personit përgjegjës, i cili ka ndjekur trajnimin e punonjësit të ri, në bashkëpunim me një person të caktuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, sipas gjendjes së vendeve të lira të punës, propozojnë:
 - a. punësimin e punonjësit të ri në "Albpetrol" Sh.A;
 - b. qëndrimin në dispozicion, në pritje për punësim.
2. Propozimi për kandidatin/punonjësin duhet të mbështetet mbi një vlerësim konkret të bërë përgjatë fazave të trajnimit, për aftësinë e tij për t'u përshtatur më mjediset e punës në Albpetrol Sh.A.
3. Propozimi i bërë i komunikohet edhe kandidatit.

KREU IV

Neni 17

Këshilli Mbikëqyrës

Dr

Këshilli Mbikëqyrës miraton çdo fundviti, së bashku me buxhetin për shoqërinë, fondin përkatës për financimin e Programit të Punësimit, për përfshirjen e profesionistëve të rinj në veprimtaritë e Albpetrol Sh.A, me kontratë pune me afat deri 12 mujor.

Neni 18

Pagesa e punonjësve të rinj, përfitues nga Programi i Punësimit

1. Punonjësit e rinj, përfitues nga Programi i Punësimit, nënshkruajnë kontratën e punës për periudhën deri në mbyllje të vitit kalendarik dhe angazhohen në programet trajnuese dhe kualifikuese të Albpetrol Sh.A.
2. Kontrata e punës është një kontratë “tip”, formati i së cilës i bashkëlidhet këtyre rregullave në pjesën ANEX.
3. Paga mujore e punonjësit me afat të caktuar përcaktohet në kontratën individuale të punës, sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës për Programin e Punësimit.
4. Pagesa do të vazhdojë pa ndërprerje për periudhën e përcaktuar në kontratë.

Neni 19

Administrimi i procesit

I gjithë procesi i realizuar nëpërmjet Programit të Punësimit dhe angazhimit të pjesëmarrëve fitues pranë Albpetrol Sh.A. nëpërmjet programeve trajnuese do të ndiqet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Njësia e Trajnimit.

Neni 20

Punësimi pa procedura konkurrimi

Punonjësit, përfitues nga Programi i Punësimit, të cilit nuk i ofrohet një vend pune në fund të periudhës së kontratës së përkohshme të punës, thirret nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në çdo rast shpalljeje të një vendi vakant në të ardhmen, duke patur të drejtën të punësohet pa procedura konkurrimi.

Neni 21

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi dy javë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës.

Për Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.

ILIA GJERMANI


KRYETAR

PJESA ANEX



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A

KONTRATË INDIVIDUALE PUNE PËR PUNONJËSIT, PËRFITUES TË PROGRAMIT TË PUNËSIMIT (*"Kontrata"*)

Kjo Kontratë Pune (më poshtë "Kontrata") lidhet sot më datë ____ . ____ . ____ prej dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

Shoqëria "ALBPETROL" Sh.A me seli në Rruga Fier-Patos, km 7, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me 30/04/1999, me NIPT J82916500U, përfaqësuar nga **Z.Elta DEDA**, shtetas shqiptarë, banues në Tiranë, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë. (këtu e më poshtë referuar si "*Punëdhënësi*")

DHE

Z. _____ i datëlindjes _____, me adresë _____, mbajtës i letërnjoftimit me numër Personal: _____, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (këtu e më poshtë referuar si "*Punëmarrësi*"),

Bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, Kontratën Kolektive të Punës, Rregulloren e Brendshme, si dhe Kodin Etik, palët e kësaj Kontrate, bien dakord të rregullojnë marrëdhënien e punësimit individual në përputhje me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Objekti i kontratës

- 1.1 Në këtë kontratë individuale pune, punëmarrësi, përfitues i Programit të Punësimit, merr përsipër të ofrojë punën dhe shërbimet e tij në kuadër të organizimit dhe urdhrave të punëdhënësit, ndërsa ky i fundit detyrohet të paguajë shpërblimin për punën e ofruar sa më poshtë vijon, në përputhje me kushtet e përcaktuara shprehimisht në këtë kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Qëllimi i Kontratës

26

2.1 Kontrata e punës ka për qëllim:

- a. të përcaktojë marrëdhëniet e punës ndërmjet Punëdhënësit dhe Punëmarrësit sipas dispozitave të legjislacionit të punës, atij të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në veçanti dhe të legjislacionit në fuqi në përgjithësi;
- b. të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, Kontratën Kolektive, Rregulloren e Brendshme, Kodin e Etikës, si dhe çdo akt tjetër të brendshëm të Shoqërisë.
- c. të konfirmojë dhe të zhvillojë bashkëpunimin reciprok ndërmjet palëve dhe vendimeve në fuqi si dhe në bazë të korrektësisë dhe reciprocitetit;
- d. të rregullojë marrëdhëniet financiare, ekonomike e sociale ndërmjet Punëdhënësit dhe Punëmarrësit.

Neni 3

Vendi dhe Pozicioni i Punës

- 3.1 Punëdhënësi punëson Punëmarrësin në postin/detyrën e “ _____”, në _____ të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.
- 3.2 Punëmarrësi do të kryejë punën e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe do t'i përmbahet në mënyrë specifike kësaj Kontrate, akteve të saj të brendshme, përshkrimit të punës, urdhrave/rregullave, procedurave të shoqërisë dhe urdhëresave, Kontratës Kolektive, Kodit të Etikës, Rregullores së Brendshme dhe Deklaratës së Konfidencialitetit të Punëdhënësit, që quhen pjesë integrale dhe e pandarë e kësaj kontrate.
- 3.3 Punëdhënësi mund të amendojë lirisht, sipas gjykimeve të tij, manualët, rregulloret, urdhërat dhe udhëzimet. Këto amendime kanë fuqi dhe janë të detyrueshme për Punëmarrësin nga momenti i marrjes dijani.
- 3.4 Punëmarrësi në rastin e ndryshimit të vendit të tij të punës, kur një gjë e tillë bëhet për shkak të nevojave të punëdhënësit dhe kur puna e re që do të kryejë i përshtatet profesionit të tij, do të lidhë kontratë të re pune për pozicionin e ri të punës me punëdhënësin.

Neni 4

Parimet

- 4.1 Gjatë ushtrimit të të drejtave dhe përmbushjes së detyrimeve, punëdhënësit, përfaqësuesit e punëdhënësve, punëmarrësit dhe përfaqësuesit e punëmarrësve duhet të udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, drejtësisë dhe bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Ata informojnë njëri-tjetrin për të gjitha faktet, kushtet, si dhe ndryshimet e tyre, të cilat janë të rëndësishme për ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve.
- 4.2 Parimi i bindjes.
- 4.3 Parimi i besnikërisë.

Neni 5

Kushtet, prova dhe kohëzgjatja

dv

- 5.1 Kjo Kontratë lidhet me afat dhe fillon t'i shtrijë efektet e saj më datë _____, sipas vendimit nr. _____, datë _____ "Për emërimin në pozicionin e punës" dhe përfundon më datë _____.
- 5.2 Koha e provës do të përfshijë një periudhë 3 (tre) mujore duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, sipas neneve 142 e 150, të Kodit të Punës.
- 5.3 Gjatë kohës së provës, paga e Punëmarrësit do të jetë e plotë si parashikohet në këtë Kontratë. Gjithashtu, kjo kohë do të njihet për efekt të vjetërsisë në punë.
- 5.4 Gjatë kohës së provës, secila nga Palët mund të zgjidhë Kontratën, duke i njoftuar vendimin Palës tjetër të paktën 5 (pesë) ditë përpara.
- 5.5 Pas përfundimit me sukses të periudhës së provës, Palët mund ta ndërpresin këtë Kontratë në përputhje me procedurën e parashikuar në Nenin 144 të Kodit të Punës, pas periudhave të lajmërimit për përfundimin, sikurse është parashikuar në Nenin 143 (1) të Kodit të Punës.
- 2 (dy) javë kur punëmarrësi ka punuar për një periudhë deri në gjashtë muaj;
- 5.6 Kontrata përfundon kur njëra nga palët zgjidh në mënyrë të njëanshme atë, duke respektuar afatet e njoftimit.
- 5.7 Që nga periudha që kjo kontratë hyn në fuqi, çdo kontratë tjetër e mëparshme bëhet e pavlefshme.

Neni 6

Koha e punës dhe Pushimet

- 6.1 Koha normale javore e punës do të jetë 40 (dyzet orë). Koha normale ditore e punës do të jetë 8 (tetë) orë nga e hëna në të premte, nga ora 07:30 – 15:30, në administratën qendrore, dhe 07:00-15:00 në Qendrat e shoqërisë.
- 6.2 Punëdhënësi, kundrejt masës së shpërblimit të parashikuar në ligj, mund të kërkojë kryerjen e orëve shtesë të punës, por jo më shumë se 200 orë në vit dhe jo kur punëmarrësi ka kryer 48 orë pune në javë. Nuk konsiderohet kohë jashtë orarit, pavarësisht orës, koha kur Punëmarrësi përmbush detyrat që duheshin plotësuar gjatë orëve normale të punës, sipas marrëveshjes paraprake me eprorin.
- 6.3 Punëmarrësi respekton orarin e punës dhe në rast sëmundjesh njofton eprorin ose burimet njerëzore brenda 48 orëve.
- 6.4 Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje. Nëse punëmarrësi punon në ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare, atëherë ai gëzon të drejtën e pushimit shtesë ose një shtesë mbi pagë.
- 6.5 Punëmarrësi ka të drejtën e pushimeve vjetore sipas parashikimeve të Kodit të Punës, të cilat janë 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës.

Neni 7

Pagesa

- 7.1 Paga mujore e pozicionit të punës do të jetë 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë. Mbi pagën mujore të pozicionit të punës shtohen dhe shtesat për vaktin ushqimor dhe antidodën.
- 7.2 Punëmarrësi do të përfitojë trajtim ushqimor në masën 500 lekë/ditë, për çdo ditë pune.

- 7.3 Në përputhje me vendet e punës përkatëse punonjesi do të përfitojë trajtim antidode në masën 100 lekë/çdo ditë pune.
- 7.4 Çdo punëmarrës ka të drejtë të dijë masën e ndalesave që u mbahet për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe çdo ndalesë tjetër që mund t'u mbahet për arsye të ndryshme.

Neni 8

Ditët e pushimit

- 8.1 Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim. Pushimet vjetore nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare. Nëse festa zyrtare bie ditën e pushimit vjetor me pagesë, pushimi vjetor shtyhet.
- 8.2 Pushimet vjetore nuk zëvendësohen me pagesë, me përjashtim të rasteve kur marrëdhënia e punës ka përfunduar dhe Punëmarrësi nuk i ka kryer pushimet që i takojnë. Në këtë rast, ai ka të drejtë për një shpërblim të barabartë me pagën e këtyre pushimeve.
- 8.3 Periudha gjatë së cilës Punëmarrësi do të marrë pushimet, programimi dhe miratimi do të kryhet sipas nevojave të punëdhënësit për vazhdimësinë e punës. Punëdhënësi ka të drejtë të ndërpresë pushimet në çdo moment për të përballuar kërkesat e punës.

Neni 9

Detyrimet e Punëmarrësit

- 9.1 Punëmarrësi duhet t'i kryejë dhe t'i ekzekutojë në mënyrë të vetëdijshme të gjitha detyrat e dhëna nga Punëdhënësi, të cilat janë në përputhje me përshtkrimin e punës, Kontratën Kolektive, Rregulloren e Brendshme, Kodin e Etikës, Deklaratën e Konfidencialitetit të Punëdhënësit dhe të Ekskluzivitetit, të cilat janë pjesë integrale e kësaj kontrate, me rregullat dhe procedurat e brendshme, me udhëzimet, kontratat dhe rregullat e shërbimit dhe gjatë gjithë kohës pritet të nxitë interesat e Punëdhënësit dhe të largohet nga gjithçka që mund t'i vërë në rrezik këto interesa.
- 9.2 Punëmarrësi është i detyruar të mbajë një figurë të pastër morale dhe etike duke mos lejuar në aktivitetin e tij veprimet e kundraligjshme, veprimet korruptive dhe evazionin fiskal.
- 9.3 Gjatë ushtrimit të detyrave, Punëmarrësi duhet të ruajë disiplinën në çdo aspekt dhe në përputhje me programin e punës; ai nuk mund të braktisë vendin e punës pa miratimin paraprak të Punëdhënësit.

Neni 10

Detyrimet e Punëdhënësit

dy

- 10.1 Punëdhënësi ka detyrimin të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e Punëmarrësit, si dhe:
- a) merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik të punonjësve;
 - b) merr të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar ngacmimin moral, të kryer prej tij dhe nga punonjësit e tjerë, si dhe afishon dispozitat mbi ngacmimin moral dhe seksual dhe sanksionet përkatëse;
 - c) parandalon çdo qëndrim që cënon dinjitetin e punëmarrësit.
 - d) siguron mbrojtjen e të dhënave për punëmarrësit.
 - e) garanton informimin, konsultimin dhe trajtimin e barabartë të punëmarrësit.

Neni 11 **Shkeljet disiplinore**

- 11.1 Do të quhen shkelje disiplinore rastet e parashikuara në Kontratën Kolektive të Punës, nr. 1026 prot., datë 10.02.2023, të ndryshuar, dhe në Rregulloren e Brendshme të shoqërisë Albpetrol sh.a.
- 11.2 Procedura disiplinore që ndiqet, afatet, mënyra e caktimit të masave disiplinore dhe e drejta e ankimit për masën disiplinore janë të përcaktuara në Kontratën Kolektive të Punës, nr. 1026 prot., datë 10.02.2023, të ndryshuar.

Neni 12 **Mbrojta e të dhënave personale**

- 12.1 Të dhënat personale:
Në përputhje me Udhëzimin Nr.11, datë 08/09/2011 mbi “Përpunimin e të Dhënave të Punonjësve në Sektorin Privat” (i ndryshuar), punonjësit e shoqërisë, me nënshkrimin e kësaj kontrate, pranojnë trajtimin e të dhënave personale (grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, këshillimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi, transmetimi etj) nga ana e punëdhënësit, me afat te ruajtjes sipas parashikimeve ligjore.

Neni 13 **Ndalimi i Konkurrencës**

- 13.1 Punëmarrësi bie dakord që për një periudhë 12-mujore, menjëherë pas përfundimit të bashkëpunimit të tij me Punëdhënësin, për çdo lloj arsyeje, me ose pa shkak, ai do të shmanget nga çdo aktivitet fitimprurës që është identik me subjektin e aktivitetit të Punëdhënësit dhe nga çdo aktivitet tjetër me natyrë konkurese me aktivitetin e Punëdhënësit.
- 13.2 Në mënyrë të veçantë, ai nuk duhet:
- a) Të punësohet nga konkurenti/ët e Punëdhënësit;
 - b) Të themelojë ose të hapë, në mënyrë direkte apo indirekte një ndërmarrje të ngjashme ose konkurrense me Punëdhënësin; të punësojë, ose për veten e tij ose për ndonjë person

AV

apo subjekt tjetër, punonjës të Punëdhënësit ose një ish punonjës, i cili është larguar nga Punëdhënësi. Në rast se Punëmarrësi kryen një nga veprimet e parashikuara në këtë nen, ai detyrohet t'i paguajë Punëdhënësit për dëmin e ardhur.

Neni 14

Parimi i Besnikërisë/Konfidencialitetit

14.1 Në përputhje me nenin 26/4 të Kodit të Punës, punëmarrësi duke respektuar "*Parimin e Besnikërisë*" duhet të ruajë fshehtësi të rreptë gjatë periudhës së punësimit dhe pas përfundimit të saj përse i përket njohjes së biznesit të Punëdhënësit dhe informacionit që Punëmarrësi ka fituar përmes punësimit me Punëdhënësin. Punëmarrësi nënshkruan *Deklaratën e Konfidencialitetit* me Punëdhënësin e cila është bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Neni 15

Përfundimi i Kontratës dhe Afatet

- 15.1 Efektet e kësaj kontrate përfundojnë me mbarimin e afatit të saj ose në momentin e zgjidhjes së saj nga njëra nga palët, pas përfundimit të afateve të njoftimit.
- 15.2 Punëdhënësi ka të drejtën të përfundojë këtë Kontratë Individuale Pune në mënyrë të menjëhershme me shkaqe të justifikuar, duke respektuar afatet dhe procedurat e parashikuara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Kontratën Kolektive në fuqi dhe Rregulloren e Brendshme të shoqërisë Albpetrol sh.a..

Neni 16

Zgjidhja e konflikteve dhe ligji i aplikueshëm

- 16.1 Çdo konflikt ose debat i ngritur në lidhje me interpretimin ose ekzekutimin e kësaj kontrate do të zgjidhet me Ndërmjetësim dhe vetëm në rastin kur ato nuk mund të zgjidhen me Ndërmjetësim, palët do t'i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
- 16.2 Kjo Kontratë është e bazuar në ligjin shqiptar dhe interpretimet, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e së cilës do të interpretohet në përputhje me ligjin shqiptar. Çdo term, ose kusht lidhur me punësimin e Punëmarrësit që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, ose në aktet e tjera të Punëdhënësit, do të interpretohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe Kontrates Kolektive në fuqi.

Neni 17

Dispozita të tjera

21

- 17.1 Kjo kontratë përbën marrëveshje mes palëve. Çdo modifikim i kësaj Kontrate do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim dhe firmoset nga të dyja Palët. Ndryshimet verbale nuk do të kenë efekt.
- 17.2 Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe, në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë, ku secila ka të njëjtën vlerë dhe secila prej tyre nënshkruhet rregullisht nga Palët.
- 17.3 Kjo kontratë anulon çdo kontratë të mëparshme midis palëve.

PUNËDHËNËSI:

PUNËMARRËSI:

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.,

ADMINISTRATOR

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Neni 1 Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet të gjithë stafit të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a., si dhe punonjësve, përfitues të Programit të Punësimit, vullnetarëve dhe palëve të tjera të cilët kanë akses në informacionin e mbajtur nga Shoqëria “Albpetrol” Sh.A.

Neni 2 Qëllimi

Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga të gjithë ata punonjës të cilët kanë akses në të dhënat personale të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a.,
Ajo përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Neni 3 Fusha e veprimit

Fusha e veprimit e kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacione konfidenciale që njihen ose mësohen gjatë punës në Shoqërinë “Albpetrol” Sh.a.,

dv

Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia e punës me Shoqërinë “Albpetrol” Sh.A., ka përfunduar.

Neni 4

Deklarata e konfidencialitetit

- *Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga Shoqëria “Albpetrol” Sh.A., përveç nëse autorizohem shprehimisht nga Shoqëria “Albpetrol” Sh.A., ose kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të tij.*
- *Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga Ligji nr.9987, datë 10.03.2008 për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Unë nuk do të përdorë ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.*
- *Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruajë konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t’i mbajë ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.*
- *Marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme.*
- *Unë e kuptoj rëndësinë e respektimit të parimit të konfidencialitetit duke e vlerësuar këtë veprim si një domosdoshmëri për të ruajtur standarte të larta profesionale në Shoqërinë “Albpetrol” Sh.A.,*

PUNËDHËNËSI

PUNËMARRËSI

dv

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Neni 1

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet të gjithë stafit të Shoqërisë "Albpetrol" Sh.a., si dhe punonjësve, përfitues të Programit të Punësimit, vullnetarëve dhe palëve të tjera të cilët kanë akses në informacionin e mbajtur nga Shoqëria "Albpetrol" Sh.A.

Neni 2

Qëllimi

Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga të gjithë ata punonjës të cilët kanë akses në të dhënat personale të Shoqërisë "Albpetrol" Sh.a.,

Ajo përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Neni 3

Fusha e veprimit

Fusha e veprimit e kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacione konfidenciale që njihen ose mësohen gjatë punës në Shoqërinë "Albpetrol" Sh.a., Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia e punës me Shoqërinë "Albpetrol" Sh.A., ka përfunduar.

Neni 4

Deklarata e konfidencialitetit

- *Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga Shoqëria "Albpetrol" Sh.A., përveç nëse autorizohem shprehimisht nga Shoqëria "Albpetrol" Sh.A., ose kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të tij.*
- *Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga Ligji nr.9987, datë 10.03.2008 për "Mbrotjtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Unë nuk do të përdorë ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.*
- *Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruajë konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbajë ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.*
- *Marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme.*

dv

- Unë e kuptoj rëndësinë e respektimit të parimit të konfidencialitetit duke e vlerësuar këtë veprim si një domosdoshmëri për të ruajtur standarte të larta profesionale në Shoqërinë "Albpetrol" Sh.A.,

PUNËDHËNËSI

PUNËMARRËSI

ok